



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Gusht 2021

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Gusht 2021

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në edicionin e këtij buletini të përmuajshëm pasqyrohen aktivitetet për muajin gusht 2021)

Njoftim për media i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) është duke i përcjellë me vëmendje audioincizimet e plasuara nga disa portale dhe është i përkushtuar për të siguruar se sistemi prokurorial dhe KPK-ja vepron vetëm konform Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, njofton opinionin publik se Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, në kuadër të kompetencave ligjore, ka parashtruar sot në KPK kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj një prokurori të kësaj prokurorie që ka të bëjë me audio-incizimet e publikuara në portalin “Shqip.com”.



KPK, në kuadër të kompetencave ligjore, do ta trajtojë këtë kërkesë të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Prishtinës, duke themeluar panelin hetimor i cili është kompetent për të trajtuar shkeljet e pretenduara.

Gjithashtu, KPK siguron opinionin publik se do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për ta trajtuar këtë rast dhe njëherësh njofton tërë opinionin publik dhe institucionet e pushtetit ekzekutiv se nuk do t'i nënshtrohet asnjë lloj presioni apo tentim-ndikimi nga jashtë, por veprimet e veta gjithnjë do të jenë në përputhje me kompetencat që ia garanton Kushtetuta dhe Ligji.

Sqarim nga Këshilli Prokurorial i Kosovës

Konferenca e organizuar nga Ministria e Drejtësisë është në vazhden e përpjekjeve për të denigruar institucionin e pavarur kushtetues, në këtë rast Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK).

Këshilli Prokurorial i Kosovës njofton opinionin publik se nuk ka bërë asnjëherë pagesa të ekspertëve mjekoligjorë në mënyrë të kundërligjshme, ashtu siç është thënë sot në një konferencë për media nga Zëvendësministri i Drejtësisë, Blerim Sallahu.

Me qëllim të sqarimit të opinionit publik, Këshilli Prokurorial kërkon nga organet ekzekutive, konkretisht nga Ministria e Drejtësisë, që për mosrealizimin e obligimeve të veta legjislative të mos ia hedhin fajin KPK-së.



Ligji në fuqi për Mjekësinë Ligjore, i vitit 2016, i sponsorizuar nga Ministria e Drejtësisë, ka paraparë në nenin 13, paragrafi 1, si vijon: “Nëpunësit e Institutit, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë marrin pjesë në ekzaminimet mjeko-ligjore për shkak të natyrës së punës kanë të drejtë në shtesë në të ardhura personale në pajtim me legjislacionin në fuqi”.

Gjithashtu në nenin 19, paragrafin 2 të këtij ligji, theksohet se “deri në nxjerrjen e akteve nënligjore sipas paragrafit 1 të këtij neni zbatohen aktet nënligjore të cilat janë në fuqi, nëse nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji”.

Për hir të njoftimit të saktë dhe të drejtë të opinionit publik lidhur me pagesat e ekspertëve mjekoligjorë, ju njoftojmë se zbatohet Udhëzimi Administrativ i Qeverisë së Kosovës nr. 07/2013 për kompensimin e punës jashtë orarit dhe

pjesëmarrjen në seanca gjyqësore të ekspertëve mjekoligjorë, ku në nenin 5 të tij obligohet Këshilli Gjyqësor dhe Prokurori i Shtetit që t’i bëjnë të gjitha pagesat për ekspertët e mjekësisë ligjore në bazë të tarifave të përcaktuara në udhëzim, të cilat ekzekutohen nga Ministria e Financave.

Edhe pse në konferencë u theksua se “me hyrjen në fuqi të këtij Ligji ishin shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore që ishin bazuar në Ligjin paraprak”, ky konstatim nuk qëndron dhe kjo shpërfaqë mosnjohuritë bazike, ligjore dhe profesionale të Zëvendësministrit të Drejtësisë, duke dezinformuar mediat dhe opinionin, ngase në Ligjin nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore të vitit 2016, me asnjë dispozitë nuk shfuqizohet asnjë akt nënligjor.

Pasi që Udhëzimi Administrativ nr. 07/2013 për kompensimin e punës jashtë orarit dhe pjesëmarrjen në seanca gjyqësore të ekspertëve mjekoligjorë nuk është shfuqizuar apo nuk është bërë plotësim-ndryshimi i të njëjtit, kompetencë kjo që tërësisht është e Qeverisë së Republikës së Kosovës, KPK-ja ka qenë e obliguar ligjërisht për realizimin e pagesave me aktet nënligjore në fuqi, me qëllim të vazhimit të përmbushjes së mandatit kushtetues dhe ligjor të Prokurorit të Shtetit.

Për vëmendjen tuaj, Këshilli Prokurorial i Kosovës i ka drejtuar kërkesë Ministrisë së Drejtësisë që ta rishikojë udhëzimin administrativ të Qeverisë së Kosovës, i cili e rregullon kompensimin e ekspertëve (bashkangjitur gjeni kërkesën e KPK-së drejtuar Ministrisë së Drejtësisë).

Po ashtu, nuk qëndron pretendimi se prokurorët i përzgjedhin ekspertët e mjekësisë ligjore, sepse të njëjtit i cakton Instituti i Mjekësisë Ligjore, i cili është në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë (bashkangjitur gjeni formën e Vendimit për ekspertizën mjeko-ligjore).

Andaj, të gjitha pretendimet e paraqitura nga Zëvendësministri i Drejtësisë ndaj Këshillit Prokurorial janë të pabaza dhe shpërfaqin mosnjohuri të thella profesionale me tendencën e vetme për të denigruar dhe goditur institucionin e pavarur kushtetues, Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Reagim i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), si organ kushtetues dhe i pavarur, është duke u atakuar padrejtësisht në vazhdimësi dhe në mënyrë të paarsyeshme nga Ministria e Drejtësisë, siç ndodhi edhe në konferencën e sotme të ministres Albulena Haxhiu.

Ju njoftojmë se Këshilli Prokurorial nuk ka nevojë që të mbështetet nga askush, aq më pak nga pushteti ekzekutiv, sepse Këshillin Prokurorial dhe Prokurorin e Shtetit i mbron Kushtetuta dhe ligjet në fuqi, e jo vullnetet politike.

Ndihma që pushteti ekzekutiv mund t'i japë sistemit prokurorial është propozimi i ligjeve adekuate në koordinim dhe bashkëpunim me Këshillin Prokurorial dhe Prokurorin e Shtetit për të avancuar pozitën e këtyre institucioneve dhe për t'i plotësuar nevojat e tyre në realizimin e mandatit kushtetues dhe ligjor, ashtu siç është e përcaktuar edhe me ndarjen e pushteteve.



Besimi i publikut në institucionet e drejtësisë nuk mund të fitohet duke i atakuar këto institucione çdo ditë me pretendime të caktuara dhe të dhëna të pasakta dhe të pabazuara, sepse kjo nuk i kontribuon bashkëpunimit të institucioneve.

Edhe sot ia bëjmë me dije opinionit publik dhe Ministres së Drejtësisë, se pagesat e ekspertëve mjekoligjorë janë realizuar në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore, të nxjerra nga Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Po ashtu, ekspertët mjekoligjorë janë zyrtarë që veprojnë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, prandaj ne iu kemi drejtuar kësaj ministrie me qëllim të rishikimit të Udhëzimit Administrativ, ngase Prokurori i Shtetit e ka të pamundur të realizojë mandatin e tij pa ekspertizat e tyre.

Në vend të atakimeve, denigrimeve dhe dezinformatave për institucionet e pavarura, në këtë rast ndaj KPK-së, Ministria e Drejtësisë duhet të punojë që sa më parë t'i nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore që rregullojnë këtë çështje, ngase Këshilli Prokurorial i Kosovës është i obliguar të vazhdojë të kompensojë shërbimet e ekspertëve mjekoligjorë në bazë të akteve nënligjore aktuale.

Sa për dijeninë e opinionit publik, shpenzimet e ekspertëve bien në barrë të të pandehurve që shpallen fajtorë me aktgjykim të formës së prerë nga ana e gjykatave.

Këshilli Prokurorial i Kosovës nuk përzgjedh ekspertët mjekoligjorë për të bërë ekspertizat e tyre profesionale, por ata caktohen nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, i cili është në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe kjo bëhet sipas "miqësive" brenda këtyre dy institucioneve.

Edhe pretendimet e ministres Haxhiu, se Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit "janë duke i mbyllur sytë prapa skandaleve të audioincizimeve" nuk qëndrojnë, sepse KPK-ja menjëherë ka filluar procedurat disiplinore ndaj një prokurori, ndërsa Prokurori i Shtetit ka ndërmarrë veprimet e veta lidhur me këto audioincizime në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore.

Sistemi prokurorial e ushtron mandatin e vet dhe do ta ushtrojë çdo herë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi dhe asnjëherë sipas dëshirave të konferencave për media dhe deklarimeve të pabazuara dhe joprofesionale të kujtdoqofshin ato.

Këshilli Prokurorial mbetet i përkushtuar për të rritur bashkëpunimin ndërinstitucional, por jo në formën dhe mënyrën të cilën e ka zgjedhur Ministria e Drejtësisë.

Themelohet Grupi punues për hartimin e Rregullores për zgjedhjen e Drejtorit të SKPK-së dhe NJSHP-së

Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i kryesuar nga prokurori Armend Zenelaj, ka mbajtur takimin e radhës, ku

janë diskutuar temat e parapara sipas rendit të ditës.

Si pikë e rendit të ditës e Komisionit në takimin e sotëm ka qenë iniciativa për formimin e Grupit punues për hartimin e Rregullore për zgjedhjen dhe shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit dhe Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.



Anëtarët e Komisionit janë pajtuar gjatë këtij takimi që të ketë vetëm një Rregullore për zgjedhjen dhe shkarkimin e dy drejtorëve.

Po ashtu janë propozuar anëtarët që do të shërbejnë në Grupin punues për hartimin e Rregullore për zgjedhjen dhe shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit dhe Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë të KPK-së, ndërsa është theksuar që kjo rregullore do të hartohet në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.

Vazhdon puna në draftimin e Rregullore për transferim dhe avancim të prokurorëve të Shtetit

Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), i kryesuar nga prokurori Armend Zenelaj, ka mbajtur takimin e radhës, ku është punuar në finalizimin e Rregullore për transferim dhe avancim të prokurorëve të Shtetit.

Në këtë takim, në të cilin kanë marrë pjesë edhe partnerët ndërkombëtarë dhe përfaqësues nga shoqëria civile, është diskutuar pikërisht për komentet e ofruara nga ta lidhur me Draftrrregulloren për transferim dhe avancim të prokurorëve të Shtetit.



Me këtë rast, Komisioni ka vendosur që të zhvillojë edhe një takim pune lidhur me finalizimin e rregullore së lartcekur, para se draftin final të saj ta dërgojë në KPK për shqyrtim dhe miratim.

Aprovohet Raportin financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i KPK-së, nën udhëheqjen e prokurores Ariana Shajkovci, kryesuese, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin janë diskutuar tri pikat e parapara me agjendë.

Si pikë të parë të këtij takimi, anëtarët e Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel kanë shqyrtuar dhe miratuar Raportin financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021.



Në vazhdim të takimit ushtruesi i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së, Valdrin Krasniqi, ka njoftuar anëtarët e Komisionit me rishikimin e buxhetit për vitin 2021.

Në fund janë shqyrtuar nevojat e prokurorive dhe njëjësive tjera të sistemit prokurorial për personel, me ç' rast Komisioni ka miratuar ndryshimet e Planit të Personelit për vitin 2021.

Ndërpritet marrëdhënia e punës së Drejtorit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës, i udhëhequr nga Kryesuesi Jetish Maloku, ka zhvilluar mbledhjen e 202-të me radhë, e cila është mbajtur online dhe në përputhje me të gjitha masat mbrojtëse kundër pandemisë Covid-19, me ç'rast janë marrë vendime lidhur me pikat e rendit të ditës.

Gjatë këtij takimi është diskutuar dhe aprovuar Raporti gjashtëmuor i mekanizmit përcjellës ndërinstitucional për veprat penale karakteristike për periudhën janar-qershor 2021.



Gjithashtu, po në këtë takim, anëtarët e Këshillit Prokurorial kanë shqyrtuar dhe aprovuar kërkesën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Gjilanit për shpalljen e brendshme për avancim të dy pozitave në Departamentin për Krime të Rënda.

Po ashtu, anëtari i KPK-së, Agron Beka, para anëtarëve të Këshillit ka prezantuar Raportin e Komisionit përzgjedhës për pozitën e Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, me ç'rast ka njoftuar anëtarët e Këshillit se ky Komision ka vendosur në mënyrë unanime që të anulohet procesi për zgjedhjen e Drejtorit të NJSHP-së deri në nxjerrjen e një rregulloreje të re.

Anëtarët e KPK-së kanë trajtuar dhe aprovuar Kërkesën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Prishtinës për caktimin e Prokurorit, Zejnullah Gashi në detyrën e Udhëheqësit të Departamentit të Krimeve të Rënda të kësaj Prokurorie.

Si pikë e rendit të ditë ishte edhe trajtimi i Raportit të Komisionit Disiplinor për rastin e Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së (i suspenduar), me ç'rast Komisioni i ka propozuar Këshillit që ndaj të njëjtit të shqiptohet masa disiplinore: Ndërprerje e Marrëdhënies së Punës, me ç'rast anëtarët e KPK-së kanë miratuar propozimin e Komisionit Disiplinor.

Po ashtu, Këshilli Prokurorial, gjatë këtij takimi ka trajtuar edhe disa pika të tjera që ndërlidhen me fushëveprimtarinë e tij.

Finalizohet drafti i Rregullores për transferimin dhe avancimin e prokurorëve

Drafti i Rregullores për transferimin dhe avancimin e prokurorëve të shtetit ishte në fokus edhe të takimit të sotëm të Komisionit për Çështje Normative të Këshillit Prokurorial të Kosovës, i cili u kryesua nga prokurori Armend Zenelaj.

Anëtarët e këtij Komisioni, partnerët ndërkombëtarë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, të cilët ofruan mbështetje të vazhdueshme me anë të komenteve të tyre, shqyrtuan çështjet procedurale të këtij akti normativ të rëndësishëm të KPK-së, të cilat qartësojnë çështjet e transferimit dhe avancimit të prokurorëve të shtetit.



Ky ishte takimi përfundimtar i Komisionit për Çështje Normative lidhur me finalizimin e rregullores së lartcekur, i cili pas rishikimit do ta dërgojë draftin final për shqyrtim dhe miratim në një nga takimet e radhës së Këshillit Prokurorial.

Telegram ngushëllimi i Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku, drejtuar Familjes Shabani, me rastin e vdekjes së ish-Kryeprokurorit të Prokurorisë Publike Komunale në Ferizaj, Ekrem Shabani

Prishtinë, 26 gusht 2021

E nderuara Familje Shabani,

Me pikëllim dhe dhimbje të thellë morëm lajmin e ndarjes nga jeta të familjarit tuaj, z. Ekrem Shabani.

Me këtë rast në emër tim personal dhe në emër të Këshillit Prokurorial të Kosovës shpreh ngushëllimet më të sinqerta për familjen, të afërmit, kolegët dhe bashkëpunëtorët e tij.



Njëkohësisht, na lejoni të ndajmë dhimbjen me ju, sepse vdekja dhe largimi i z. Ekrem Shabani nga kjo botë është humbje jo vetëm për juve si familje, por edhe për ne kolegët dhe bashkëpunëtorët e tij, ngaqë kudo la gjurmë të një profesionisti të dalluar dhe të një njeriu që kishte virtyte të larta dhe integritet të madh njerëzor e kombëtar.

Qoftë i përjetshëm kujtimi për të!

Me respekt,

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial

Jetish Maloku

Mbahet takimi i përbashkët i Komisionit për Çështje Normative dhe Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel

Anëtarët e dy komisioneve të përhershme të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK): Komisionit për Çështje Normative dhe Komisionit për Buxhet,

Financa dhe Personel, mbajtën një takim të përbashkët, në të cilin ishte në fokus trajtimi i disa kërkesave të ndryshme.



Nga takimin e fundit të Këshillit Prokurorial të Kosovës është marrë vendim që Komisioni për Çështje Normative dhe Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel të trajtojnë kërkesën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Prishtinës për shtesa në pagë për prokurorët e Njësitit Kundër Korrupsionit të kësaj prokurorie.

Gjithashtu, gjatë këtij takimi të përbashkët është diskutuar edhe angazhimi i ekspertëve gjyqësorë dhe kompensimi i tyre dhe është shqyrtuar kërkesa e Odës së Avokatëve të Kosovës për ngritjen e tarifave të përfaqësimit, me ç'rast u tha se kjo kërkesë do të trajtohet në koordinim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

SKPK-ja ka ofruar komentet e KPK-së në Raportin e dytë tremujor të projektit EUKOJUST dhe është në proces përgatitja e Raportit për zbatimin e Planit strategjik të sistemit prokurorial 2019-2021.

Po ashtu është bërë shpërndarja e kopjeve fizike të Udhëzuesit për veprat penale të korrupsionit, i miratuar nga Gjykata Supreme në qershor 2021, në të gjitha prokuroritë e Kosovës dhe është hartuar drafti i kërkesës për mendimi juridik drejtuar Ministrisë së Drejtësisë lidhur me pagesat e institucioneve publike pas kryerjes së ekspertizave sipas kërkesës së Prokurorit të Shtetit.

Ka vazhduar edhe procesi i grumbullimit dhe administrimit të dhënave të 12 prokurorëve me mandat të përhershëm, në kuadër të procesit të tretë të vlerësimit dhe janë realizuar dy punëtori

me prokurorët e dy prokurorive themelore: Pejë dhe Gjakovë, në të cilat komisioni përkatës i ka njoftuar prokurorët me sistemin e ri të vlerësimit të performances së prokurorëve dhe ka informuar kryeprokurorët për obligimet dhe mënyrën e vlerësimit vjetor të prokurorëve të prokurorisë

Është duke vazhduar puna në hartimin e Raportit analitik 2013-2020 për veprat penale karakteristike të Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional dhe janë përgatitur raporte të ndryshme nga fushëveprimtaria e burimeve njerëzore, si dhe është pranuar dhe diskutuar Raporti i auditimit të brendshëm në fushën për buxhet dhe financa.

Nga ana tjetër është përgatitur Plani i veprimit dhe është punuar në përgatitjen e formave të raporteve për datatbazën e DBF-së dhe është mbajtur takim me prokurorët e Departamentit të Përgjithshëm dhe të Departamentit të Krimeve të Rënda, ku është diskutuar shpërndarja automatike e lëndëve.

Gjatë muajit është finalizuar edhe regjistri elektronik i lëndëve për kryerësit e panjohur në SMIL. Ky aktivitet do të mundësojë largimin e regjistrimit fizik PPP dhe zëvendësim e tij me elektronik, si dhe ka filluar zhvillimi i modulit të raporteve statistikore në sistemin elektronik për menaxhimin e dosjeve të prokurorëve.

Është finalizuar raporti për zbatimin e Planit Strategjik të sistemit prokurorial 2019-2021 dhe ka pasur angazhime në hartimin e Raportit analitik 2013-2020 për veprat penale karakteristike të Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional dhe është mbajtur takim me Grupin punues për monitorimin e listës së rreziqeve në sistemin prokurorial.

Pas rishikimit të buxhetit të vitit 2021, Njësia e Prokurimit në MPB është duke bërë analizimin dhe vlerësimin e vazhdimin të zbatimit të projektit për Pallatin e Drejtësisë.

Është mbajtur takim me përfaqësues të projektit të Norvegjisë, i cili ka për qëllim ofrimin e mbështetjes së Projektit TIK/SMIL. Në takim është prezantuar drafti i dokumentit të Projektit TIK/SMIL të fazës së tranzicionit për periudhën 2021–2024, si dhe është dërguar kërkesë në

Ambasadën Amerikane për mbështetje financiare në sigurimin e një softueri për transkriptimin automatik të zërit në tekst. Ky softuer do të mundësojë përpilimin e shpejtë dhe të saktë të procesverbaleve të takimeve të Këshillit, ndërsa në prokurori do të jetë e nevojshme gjatë marrjes në pyetje të palëve.

Rrjedhimisht janë ofruar informata sipas kërkesës së Zyrës së Kryeministrit lidhur me Planin e Veprimit të Agjendës për Reformë Evropiane (ERA) dhe është mbajtur takim me ekspertë të projektit britanik lidhur me studimin gjinor, që janë duke e realizuar për sistemin prokurorial.

Janë përfshirë komentet e njësisë kompetente në Raportin për zbatimin e Planit Strategjik të sistemit prokurorial 2019-2021 dhe është bërë publikimi i versionin të ri të Sistemit për Menaxhimin e Dosjeve të Prokurorëve – SEMDP.

Ndërkohë është futur në zbatim shkëmbimi elektronik i të dhënave me Policinë e Kosovës përkatësisht moduli i hetimeve. Shkëmbimi elektronik i të dhënave me modulën e hetimeve së pari do të zbatohet me Drejtorinë e Hetimeve të Trafikimit me Narkotik (DHTN) dhe Drejtorinë për Hetimin e Krime Ekonomike (DHKE), ndërsa nga 1 tetori do të fillojmë me të gjitha drejtoritë në kuadër të Policës së Kosovës. Me këtë arrihet që të kemi një shkëmbim të plotë të të dhënave në mes të prokurorisë dhe policisë.

Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

Në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara në gusht nga ana e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë ishte përqendrimi në hartimin e Raportit për gjashtëmujorin e parë të punës së PSH-së, hartimin e Raportit për normën orientuese të prokurorëve për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, mbështetjen e procesit të rekrutimit, transferimeve dhe avancimeve të prokurorëve përmes zyrtarëve të caktuar nga KPK për realizimin e këtyre proceseve, në përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave në dosjet fizike dhe elektronike të prokurorëve, organizimin dhe pjesëmarrjen në takimin e grupit punues për vlerësimin e furnizimit të prokurorive me material shpenzues, inventarizimin si dhe qasjen e palëve në prokurori, përgatitjen e informatave në

kompetencë të ZMAVP-së për mekanizmat e brendshëm të sistemit prokurorial në mbështetje të proceseve të punës që janë zhvilluar gjatë muajit korrik, si dhe angazhime të tjera në përbushje të obligimeve ligjore në kuadër të ZMAVP.

Aktivitetet e Zyrës për Trajnime ka ofruar të dhëna sa i përket trajnimeve me temën e "Ndërmjetësimit" për shkak të numrit të ulët të zgjidhjes së rasteve me procedurën e ndërmjetësimit, me qëllim që këto të dhëna të shërbejnë për fazën e monitorimit të listës së rreziqeve lidhur me objektivin 22 - zbatimi efektiv i procedurave alternative për zgjidhjen e kontesteve.

Gjithashtu është përgatitur raporti për pjesëmarrjen e prokurorëve në aktivitetet e edukimit ligjor me temën e "Ndërmjetësimit", i cili përmban datën e mbajtjes së trajnimit, organizatorin, llojin e trajnimit, numrin e prokurorëve pjesëmarrës në trajnim, si dhe numrin e prokurorëve si ligjërues dhe numrin e stafit administrativ në këto trajnime.

Po ashtu është përgatitur Raporti për pjesëmarrjen e prokurorëve në trajnime me temën "Krimet e luftës".

Pjesëmarrja e prokurorëve në aktivitet e edukimit ligjor ka vazhduar me trajnime në bashkëpunim me Akademia e Drejtësisë dhe projektin e KE-së i PROCEEDS-2, duke realizuar punëtorinë për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar. Qëllimi i punëtorisë është të vlerësojë dhe të përmirësojë procedurën lidhur me bashkëpunimin juridik ndërkombëtar.

Si rezultat përfundimtar i punëtorisë ishte që ekspertët do të hartojnë një raport kompleks me udhëzime për një procedurë efikase për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar. Ky raport do të diskutohet në një takim të radhës në fund të muajit tetor.

Në punëtori u trajtuan pikat e mëposhtme të interesit si:

- Legjislacioni vendor për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, përfshirë traktatet dypalëshe dhe traktatet shumëpalëshe;
- Modele ekzistuese për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar dhe

- Manualët ekzistues të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar për gjyqtarët dhe prokurorët.

Pjesëmarrës në punëtori ishin prokurorët nga Prokuroria Themelore e Prishtinës dhe ajo e Pejës, si dhe zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë.